



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

V E N D I M

Nr. 178 / Prot

Shkodër me 18.03 2025

Nr. 09, Datë 13.03.2025

"MBI MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMEVE DHE PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË ARDHURAVE DHE TAVANET PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 NË NIVEL PROGRAMI"

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 13.03.2025, pasi dëgjoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër "Mbi miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të Ardhurave dhe Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 në nivel programi", bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenin 34 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes Vendore", Udhëzimit Nr.8, datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim**,

V E N D O S I;

1. Të miratojë **Raportin për Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave të Këshillit të Qarkut Shkodër** për;
 - a) Dy vitet para vitit buxhetor,
 - b) Vitin buxhetor,
 - c) Tre vitet e ardhshme buxhetore,
2. Të miratojë **Tavanet Përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028**, për Këshillin e Qarkut Shkodër sipas pasqyrave bashkangjitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

